

Kompresori i ajrit të kondicionuar

Hapat e punës për ndërrimin e tij

Njoftim për sigurinë:
Mbajta e syzeve dhe e dorezave mbrojtëse gjatë zëvendësimit të kompresorit të ajrit të kondicionuar është e detyrueshme!

1 Ekstraktohet refrigeranti:

- Evakuohet plotësisht refrigeranti.
- Hiqet presioni nga sistemi: Edhe pas ekstraktimit mund të rrjedhë refrigerant, i cili është i integruar në vajin e kompresorit të ajrit të kondicionuar. Prandaj hapet qarku i refrigerantit menjëherë pas evakuimit në mënyrë që të parandalohet një rritje tjetër e presionit.

2 Çmontohet kompresori i ajrit të kondicionuar:

- Hiqet rripi i transmisionit, lirohen kabujt lidhës dhe bulonat në kompresorin e ajrit të kondicionuar.
- Mbyllet linjat e kabujve lidhës për të parandaluar depërtimin e papastërtisë dhe lagështisë.

3 Kontrollonhet sistemi:

Inspektim vizual i të gjithë përbërësve për rrjedhje dhe dëmtime: p.sh. goditje guri tek kondensatori i ajrit të kondicionuar, rrip V me pore, linja presioni me rrjedhje, kablo dhe prizat të dëmtuara.

4 Shpëlahet sistemi:

Duhet patur me patjetër parasysh: Zëvendësimi i kompresorit të ajrit të kondicionuar kërkon shpëlarjen e të gjithë sistemit të ajrit të kondicionuar dhe zëvendësimin e materialeve të konsumit dhe përbërësve që nuk shpëlahen! Grimcat e papastërtisë në qarkun e ajrit të kondicionuar mund të hiqen vetëm duke shpëlarë tërësisht sistemin. Në varësi të shkallës së ndotjes, për shpëlarje janë të përshtatshëm refrigerantët R134a ose R1234yf ose një tretësirë e veçantë shpëlarjeje. Kompresorët e ajrit të kondicionuar, tharësit e filtrit dhe akumuluesit, si dhe valvulat e zgjerimit ose mbyllëse nuk mund të shpëlahen.

Duke qenë se në rast defekti të kompresorit të ajrit të kondicionuar gjithmonë duhet supozuar, ose nuk duhet përjashtuar fakti, se shkaku është ndotja e sistemit (gërryerje, ashklla), shpëlarja e sistemit është absolutisht thelbësore gjatë zëvendësimit të këtyre komponentëve.

5 Zëvendësohet valvula e zgjerimit/e mbylljes, tharësi i filtrit/akumuluesit dhe unazat O:

- Rinovohen të gjitha guarnicionet në lidhjet e hapura dhe njomen me vaj të pastër kompresori.
- Kapakët e vulosjes hiqen nga akumuluesi/tharësi i filtrit vetëm direkt para montimit.

6 Mbushet në mënyrën e duhur kompresori i ajrit të kondicionuar:

a) Shpërndarja e sasisë së vajit (shih grafikun më poshtë)

Në çdo përbërës të sistemit të ajrit të kondicionuar ka vaj refrigerant. Në rast të një riparimi, vaji hiqet bashkë me përbërësin që zëvendësohet. Prandaj është tepër e domosdoshme të mbushet përsëri sasia përkatëse e vajit.

b) Kushtojini vëmendje llojit të vajit dhe specifikimeve

Para montimit të një kompresori të ri të ajrit të kondicionuar, sasia dhe viskoziteti i vajit duhet të kontrollohen gjithmonë në përputhje me udhëzimet e prodhuesit dhe të rimbushet nëse është e nevojshme!

6 Mbushet kompresori i ajrit të kondicionuar në mënyrën e duhur:

c) Sasia e duhur e vajit të sistemit

Meqenëse i njëjti kompresor i ajrit të kondicionuar mund të përdoret për automjete ose sisteme të ndryshme, është me patjetër e domosdoshme të kontrollohet ose të korrigohet sasia e mbushjes së vajit para montimit të kompresorit të ajrit të kondicionuar. Për ta bërë këtë, i gjithë vaji duhet të kullohet nga kompresori i ajrit të kondicionuar dhe të mblidhet. Më pas, kompresori i ajrit të kondicionuar duhet të rimbushet me të gjithë sasinë e vajit të specifikuar nga prodhuesi i automjetit (sasia e vajit të sistemit).

Për të siguruar që vaji të shpërndahet në mënyrë të barabartë, para se të montohet kompresori i ajrit të kondicionuar duhet të vendoset vertikalisht për 3 minuta, me diskun e transmisionit të kthyer poshtë, dhe më pas të rrotullohet 10 herë me dorë.

7 Montohet kompresori i ri i ajrit të kondicionuar:

- Respektohet shtrirja dhe drejtimi i saktë i rripave të transmisionit.
- Lidhen kablot dhe linjat e tubave.
- Këshillë praktike për sitat e filtrit të kompresorit të ajrit të kondicionuar: nëse është e nevojshme, para montimit instalohet sita e filtrit në linjën e ekstraktimit tek kompresori i ajrit të kondicionuar.

8 Mbushet sistemi:

- Evakuohet qarku i refrigerantit me pajisjen e shërbimit të ajrit të kondicionuar: kjo largon çdo lagështi tjetër që mund të ketë mbetur. Nuk duhet tejkaluar kohëzgjatja minimale prej 20 minutash.
- Refrigeranti zakonisht mbushet vetëm me anë të stacionit të shërbimit të ajrit të kondicionuar, nëpërmjet lidhjes anësore me presion të lartë, në mënyrë që të shmangen goditjet e refrigerantit në kompresorin e ajrit të kondicionuar.
- Lejohet të përdoret vetëm refrigeranti përkatës në sasinë/specifikimin e përcaktuar nga prodhuesi i automjetit.

9 Vënia në funksionim:


- Vendoset shpërndarja e ajrit në pozicionin "gryzat në qendër" dhe hapen të gjitha gryzat e qendrës.
- Butoni për nxjerrjen e ajrit të pastër vendoset në nivelin e mesëm.
- Vendoset temperatura në kapacitetin maksimal të ftohjes.
- Ndizet motori (pa funksionin e sistemit të ajrit të kondicionuar) dhe mbahet ndezur pa pushim për të paktën 2 minuta me shpejtësi boshe.
- Aktivizohet ajri i kondicionuar me shpejtësi boshe për rreth 10 sekonda - fiket ajri i kondicionuar për rreth 10 sekonda.
- Ky proces përsëritet të paktën 5 herë.

10 Testi i presionit të sistemit dhe i padepërtueshmërisë:

- Kontrollohet kapaciteti i ftohjes, funksioni dhe sistemi në rast se ka rrjedhje.
- Krahasohen vlerat e presionit të ulët në pajisjen e shërbimit të ajrit të kondicionuar me vlerat e synuara.
- Nëse është shtuar lëng kontrasti, kontrollohet për rrjedhje me një llambë UV.

11 Punët përfundimtare:

- Bëhet udhëtimi provë.
- Vendoset pulla për kryerjen e shërbimit.
- Dokumentohen punët e kryera.



mahle-aftermarket.com

BEHR®

MAHLE